

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR NJË SHITESË NË AKTIN NORMATIV NR.3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUdhËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij akti normativ është parashikimi i një shtese në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij akti normative parashikohet të penalizohen subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike në stacionet e plazhit dhe që nuk respektojnë rregullat dhe protokollet e sigurisë, të nxjerra nga organet kompetente, me dënimin me gjobë 700 000 (shtatëqind) mijë lekë dhe, në rast përsëritjeje, iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë nga inspektoratet përgjegjëse, duke synuar kështu të mbrohet shëndeti i turistëve në zonat e plazheve nga infeksioni Covid-19 si edhe mjedisi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky akt normativ është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, por nuk është parashikuar në programin analitik të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apo të Ministrisë së Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Shqipëria ashtu si edhe gjithë bota është e përfshirë nga përhapja e infeksionit Covid-19.

Në kushtet e gjendjes së epidemisë dhe një pandemie mbarëbotërore të gjithë vendet paralel me masat shëndetësore për mbrojtjen e shëndetit të popullatës ndaj përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 kanë ndërmarrë edhe masa të tjera të ndryshme.

Një vëmendje e veçantë në prag të sezonit turistik, Qeveria Shqiptare po i kushton marrjes së masave për mbrojtjen e shëndetit publik në përgjithësi dhe mbrojtjen e shëndetit të turistëve që do frekuentojnë plazhet nga infeksioni Covid -19. Gjithashtu një vëmendje të veçantë në prag të hapjes së sezonit turistik i kushtohet edhe mbrojtjes së mjedisit nga subjektet që kanë në fushën e tyre të veprimtarisë ofrimin e shërbimeve të ndryshme për turistët.

Në kuadër të mbrojtjes së shëndetit publik janë miratuar akte të ndryshme që parashikojnë rregullime, masa higjieno-sanitare dhe protokolle që duhen zbatuar nga subjektet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Zbatimi i protokolleve të miratuara dhe masave që duhet të ndërmarrin subjektet për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid -19 do jenë subjekt monitorimi, dhe moszbatimi i tyre nga subjektet do të shoqërohet sipas rastit me masa administrative dhe /ose penale sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Nëpërmjet këtij akti normative parashikohet të penalizohen subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike në stacionet e plazhit dhe që nuk respektojnë rregullat, dhe protokollat e nxjerra nga organet kompetente, me dënimin me gjobë 700 000 (shtatëqind) mijë lekë dhe, në rast përsëritjeje, iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë nga inspektoratet përgjegjëse, duke synuar kështu të mbrohet shëndeti i turistëve në zonat e plazheve nga infeksioni Covid-19 si edhe mjedisi.

Duke marrë parasysh fluksin e turistëve në zonat e plazheve gjatë sezonit turistik, me synim mbrojtjen e shëndetit të tyre por edhe të shëndetit publik në tërësi, si edhe me qëllim mbrojtjen e mjedisit, subjektet duhet të respektojnë rregullat dhe protokollat e sigurisë¹³⁷, të nxjerra nga organet kompetente, për të zvogëluar transmetimin e infeksionit Covid-19 midis punonjësve, për të vazhduar normalisht aktivitetin dhe për të siguruar një ambient të shëndetshëm në punë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky akt normativ është në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky akt normativ nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Akti normativ ka 2 nene në përmbajtjen e tij.

Neni 1 parashikon që në nenin 3 të shtohet pika 22, me këtë përmbajtje:

“22. Subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike në stacionet e plazhit dhe që nuk respektojnë rregullat, dhe protokollet e nxjerra nga organet kompetente, dënohen me gjobë 700 000 (shtatëqind) mijë lekë dhe, në rast përsëritjeje, iu shtohet edhe mbyllja e veprimtarisë nga inspektoratet përgjegjëse”.

Neni 2 parashikon hyrjen në fuqi menjëherë të aktit normativ dhe botimin në “Fletoren zyrtare”.

VI. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky akt normativ u hartua nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Brendshme.

VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky akt normativ nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE